

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Spahiu: Gjykata e Apelit do të shpallë të pafajshëm Hashim Thaçin, njësoj si gjenerali kroat Ante Godovina
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajon/spahiu-gjykata-e-apelit-do-te-shpalle-te-pafajshem-hashim-thaci-njesoj-si-i586534
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 16:13:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 16:06:01 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8401d3a2abc6bef3b7085e505b5d2ce15f6b14699fdbf0754ad8d154a77533be
TEKSTI	216b21f8edac21a4a68cff9f7e2ca49ff1a03c6c1f96ee8faf6753f5024a2638
PAMJA	38dee68e6e67840c82e2445d7aab09696df478828fa4f02b2789214e11cb3b80

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	870586df9670925b1761a3a517ee2c3a6c5070790d1906200b431bca89a51037
E MËPARSHMJA	186ef1c9e8bec5af607450a47667dd68ab53066a429b2b3be2433fc3820f1f4f
RRËNJA MERKLE	9515102868483048fab913125dfd13516db18986db3bd96a2369642ebf1c0d96
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/870586df9670925b1761a3a517ee2c3a6c5070790d1906200b431bca89a51037>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 [English](#)



ie [Plagoset me arme zjarr avokati ne Durres, policia ne kerkim te autorit, zbardhen emratSulmi me dron - Ukraina pretendon se ka vrare gjeneralin e rendesishem rusA u fundit](#)

Spahiu: Gjykata e Apelit do të shpallë të pafajshëm Hashim Thaçin, njësoj si gjenerali kroat Ante Godovina



16 Shtator 2026, 18:06Rajoni TEMA



Juristi Kreshnik Spahiu në një lidhje të drejtëpërdrejtë në 'Sot Live në Shqipëri' foli rreth vendimit të Gjykatës Speciale të Hagës për 4-ish krerët e UÇK, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi.

Spahiu theksoi se kjo ishte diçka e pritshme nga kjo Gjykatë, dhe kjo është vetëm beteja e parë. Sipas tij Gjykata e Apelit do t'i japë pafajësi Thaçit ashtu siç i dha pafajësinë gjenerali kroat Ante Godovina.

"Kjo është beteja e parë, të gjithë duhet të ishim të përgatitur, për një humbje, se nga këta gjyqtarë nuk mund të prisim më shumë. Kjo Gjykatë nga mënyra si u ndërtua nuk ishte krijuar për t'i dhënë pafajësi Kosovës por për të vendosur balanca politike në kurriz të drejtave të kombeve. Ishte projektuar kombin shqiptar. Beteja ligjore vijon, ka shpresa. Gjykata e Apelit do t'i japë pafajësi Thaçit ashtu siç i dha pafajësinë gjenerali kroat Ante Godovina kur Gjykata e Shkallës së Parë e dënoi me 24 vite burg. Hashim Thaçi bashkë me tre të tjerët janë më të favorizuar se Ante Godovina, i kanë të gjitha faktet juridike, faktet, provat dëshmitarët në favor të tyre", tha Thaçi.

Ndër të tjera ai nënvizoi se kjo Gjykatë ka qenë koniunkturave diplomatike që e duan Hashim Thaçin në burg. Spahiu risolli në vëmendje edhe arrestimin e Thaçit, pikërisht 2 orë para se të nisej drejt Shtëpisë së Bardhë.

"Unë mendoj se kjo Gjykatë Speciale do të reflektojë në Gjykatën e Apelit. Ne duhet të jemi edhe profesionistë përveçse patriot. Unë kam besim që Gjykata e Apelit do t'i çojë drejt pafajësisë ish-krerët e UCK. Është dhënë vetëm një sinjal për balanca politike. Unë mendoj se kjo Gjykatë ka qenë nën influencën koniunkturave diplomatike që e duan Hashim Thaçin në burg. Hashim Thaçi është arrestuar në disa momente politike të përplasjeve diplomatike mes Europës dhe SHBA.

Thaçi u arrestua dy orë para se të nisej në Uashington, 2 orë para se të fluturonte për të takuar Donald Trump, 2 orë para të nënshkruante një marrëveshje të njohjes Kosovë-Serbi që akoma nuk e kemi. Është një viktimitë e gjeopolitikës europiane dhe SHBA-së. Kam besim e drejta do të dominojë mbi presionin politik. Liderët pro amerikan në Kosovë e duan Thaçin në burg. Të dënohesh me 25 vite, është të vdesësh në burg", tha Spahiu.

1 Komente



Koli

16 Shtator 2026, 18:13

Ja,e dha verdictin ky gjyqtari modh i republikes se bananeve..Tani futini nje dore gjume.,dhe e hajme pastaj.Duhet pune,pare dhe men me fitu ne apel.Duhet me kap studiot ligjore me te mira n'bote.

↩ **Përgjigjuni**

👍 0 🗳️ 2 ❤️ 0

💬 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Dënimi i liderëve të UÇK-së, reagon Zagrebi zyrtar: Vendimi në Hagë nuk e ndryshon kontekstin e luftës

18:00 Rajoni / 1 koment

Britania reagon pas vendimit për ish-krerët e UÇK-së: Aktgjykimi të mos përdoret për të nxitur tensione

17:50 Rajoni / 2 komente

Rrëzimi i akuzave për 'krime kundër njerëzimit' në Hagë, prokurorja West: Vendimi do të analizohet me kujdes

17:40 Rajoni , 5 komente

Dënimi i ish-krerëve të UÇK, DASH: Shmangni retorikën nxitëse, punoni për një të ardhme paqësore

17:00 Rajoni , 4 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.